



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 153/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Elezaj” shpk, dhe kualifikimin e ofertuesve të tjerë në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-42009-01-24-2018, me objekt: *“Ruajtja me Roje Private ne godinen e DRSH Fier me 3 turne si dhe ne Sherbimin Stomatologjik Publik me turn te pare dhe sistem alarmi 24- ore”*, Marreveshje Kuader, me fond limit 3.382.895 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier.

Ankimues:

“Elezaj” sh.p.k
L.“Xh.Nepravishta”, Rr.“K.Roshi”, Kati parë, ZK Nr. 8571,
Lushnje

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier
Lagja “1Maj” Rruga “Jani Bakalli”,
Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë

17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 25.01.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. Ref-42009-01-24-2018, me objekt: “*Ruajtja me Roje Private ne godinen e DRSH Fier me 3 turne si dhe ne Sherbimin Stomatologjik Publik me turn te pare dhe sistem alarmi 24- ore*”, Marreveshje Kuader, me fond limit 3.382.895 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier.

II.2. Në datën 06.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Operatorët ekonomikë kanë paraqitur ofertat si më poshtë vijon:

1. “Buzi” sh.p.k	2.907.366,30 lekë, skualifikuar
2. “Polsaiz” sh.p.k	3.278.429,94 lekë, kualifikuar
3. “Eurogjici Security” sh.p.k	3.382.370,04 lekë, skualifikuar
4. “Elezaj” sh.p.k	3.382.425,97 lekë, skualifikuar
5. “Goga” sh.p.k	3.382.689,17 lekë, skualifikuar
6. “Nazeri 2000” sh.p.k	3.382.699,04 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 06.02.2018 operatori ekonomik ankimues “Elezaj” shpk, është njoftuar elektronikisht mbi skualifikimin e tij pasi:

1. *Ne Vertetimin e Policise se Qarkut Fier nuk pasqyrohet, grup i gatshem per verifikim e sinjaleve elektronike per objektet qe jane te lidhura me sisteme elektronike.*
2. *Nuk ka paraqitur, deshmi te lejes se drejtimit te mjetit.*

II.4. Në datën 12.02.2018 operatori ekonomik ankimues “Elezaj” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“-Nuk jemi dakort me argumentin e autoritetit kontraktor se “ne Vertetimin e Policise se Qarkut Fier nuk pasqyrohet, grup i gatshem per verifikim e sinjaleve elektronike per objektet qe jane te lidhura me sisteme elektronike” pasi [...] nga provat e paraqitura në sistem nga ana e operatorit ekonomik rezulton se shoqëria “Elezaj” sh.p.k ka grup të gatshëm për verifikimin e sinjaleve elektronike, duke paraqitur si provë konkretisht: Vërtetimi I performancës të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier me nr.361 prot, datë 14.12.2017. Gjithashtu pretendimi I skualifikimin e operatorit ekonomik të bërë nga KVO e AK-së bie ndesh edhe me rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Komsionit të Prokurimit Publik me nr. 15166 prot., datë 20.12.2017 dhe konkretisht: në lidhje me Qendrën e Kontrollit të kërkohet paraqitja e Akt Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Qarkut ku ushtron aktivitetin SHPSF.

-Nuk kjemi dakort me arsyen e skualifikimit: “Nuk ka paraqitur, deshmi te lejes se drejtimit te mjetit”, pasi shoqëria “Elezaj” sh.p.k ka paraqitur mjetin në pronësi të saj shoqëruar me leje qarkullimi, kontroll teknik, certifikatë pronësie, taksa vjetore, policën e sigurimit t ëmjetit, certifikatën e kontrollit teknik. [...] Sipas vërtetimit të performancës të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Qarkut Fier përdorues mjeti është personi me inicilaet K.D.

-Ofertat e shoqërivë “Buzi” sh.p.k, “Polsaiz” sh.p.k dhe “Eurogjici Security” sh.p.k nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për shtesë page për turn të dytë dhe të tretë dhe sigurimet shoqërore [...].”

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 242/1 prot., datë 13.02.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 16.02.2018 operatori ekonomik “Elezaj” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 28.02.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 268/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 287/1 prot., datë 26.02.2018 me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Elezaj” sh.p.k se kjo shoqëri *nuk ka paraqitur, deshmi te lejes se drejtimit te mjetit*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 5, e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

“Ofertuesi duhet të disponojë se paku **1 automjet** për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marre me qera. Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit ne pronesi te shoqerise. Përdoruesit e mjetit te kenë dëshminë e lejes se drejtimit të mjetit.

Ne rastin kur automjeti eshte marre me qera, Leja e Qarkullimit duhet te shoqerohet edhe me Kontraten noteriale te marrjes me qera, ku te jete percaktuar afati dhe qellimi i marrjes me qera.”

III.1.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues rezulton se, për plotësimin e kërkesës së mësipërme, është paraqitur dokumentacioni si vijon:

1. *Leje qarkullimi për automjetin me targë AA936ND në emër të shoqërisë “Elezaj” sh.p.k*
2. *Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targë AA936 ND, në emër të shoqërisë “Elezaj” sh.p.k.*
3. *Taksat e automjetit AA936ND në pronësi të shoqërisë “Elezaj” sh.p.k*
4. *Siguracioni i automjetit AA936ND në pronësi të shoqërisë “Elezaj” sh.p.k.*
5. *Çertifikatë kontrolli e automjetit AA936ND.*
6. *Vërtetim nr. 361 prot., datë 14.12.2017, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier për performancën e subjektit SH.P.S.F “Elezaj” sh.p.k.*

Sipas kësaj shkrese, përdoruesi i mjetit AA936ND është personi me inicialet K.D.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.
b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 2 dhe 5/ç të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

[...] dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues “Elezaj” shpk nuk ka dorëzuar në SPE, dëshminë e lejes se drejtimit të personit me inicialet K.D që është përdoruesi i mjetit me targë AA936ND.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe

vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Elezaj” sh.p.k nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me paraqitjen nga ana e përdoruesit të mjetit të dëshmisë së lejes së drejtimit.

Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik “Elezaj” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar arsyetimit të dhënë më sipër në pikën III.1. gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të pranimit/kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike edhe pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të ndryshojë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Elezaj” sh.p.k përsa i përket operatorëve të tjerë ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërisht nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Elezaj” sh.p.k. mbetet i skualifikuar në bazë të arsytimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimit të tij në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tij të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Elezaj” sh.p.k për procedurën e prokurimit Nr. Ref-42009-01-24-2018, me objekt: *“Ruajtja me Roje Private ne godinen e DRSH Fier me 3 turne si dhe ne Sherbimin Stomatologjik Publik me turn te pare dhe sistem alarmi 24- ore”*, Marreveshje Kuader , me fond limit 3.382.895 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit. .
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 268 Protokolli;

Datë 16.02.2018

